



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_981_06_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 16.07.2013.

në seancën e mbajtur më datë 06 shtator 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e parashtruesit të ankesës H.M. (shifra e konsumatorit: DPR - 20946) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_981_06_13 i datës 25.06.2013.

Arsyetim

Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin janar 2013 me shpenzim prej 2232 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 204.5€. Pas arritjes së kësaj fature konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën janar 2013 për shkak të leximit jo të saktë/korrektë.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 07.03.2013 iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e shpenzimit dhe listave të leximit. Pas kësaj konsumatori i drejtuar DMK në ZRRE duke kundërshtuar përgjigjen e KEK-un lidhur me ankesën ndaj faturës së energjisë elektrik për muajin 01/2013.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 25.06.2013 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 16.07.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_981_06_13 të datës 25.06.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nuk pajtohet me vendimin e DMK-së pasi që konsideron se vlera e shprehur në faturë nuk është reale.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me datë 06.09.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.



Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se për muajin janar 2013 Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 e ka faturuar konsumatorin me shpenzim mujor prej 2232 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 204.50€.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar listat e leximit të KEK-ut prej periudhës 10/2012 e deri më 02/2013 dhe ka vërejtur se konsumatori ka lexim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Nga periudha 10/2012 e deri më 02/2013 vërehet se lexuesi i KEK-ut për çdo muaj ka lexuar pikën matëse dhe ka evidentuar shpenzimet e energjisë elektrike për çdo muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe atyre në lista të leximit dhe ka vërejtur se gjendja e evidentuar në periudhën e muajit janar 2013 në rrjedhën e energjisë përputhet me atë listës së leximit të KEK-ut.

Bordi ka analizuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike dhe ka vërejtur se shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën e njëjtë të vitit paraprak është pothuajse i njëjtë: për periudhën 11/2011 shpenzimi i energjisë elektrike është 1321 kWh, ndërsa për periudhën 11/2012 është 1326 kWh; për periudhën 12/2011 shpenzimi i energjisë elektrike është 1139 kWh ndërsa për periudhën 12/2012 është 1832 kWh; periudhën 01/2012 shpenzimi i energjisë elektrike është 2166 kWh ndërsa për periudhën 01/2013 është 2232 kWh; dhe për periudhën 02/2012 shpenzimi i energjisë elektrike është 1922 kWh, ndërsa për periudhën 02/2013 është 1360 kWh. Sipas kësaj vërehet qartë se edhe muajve të tjerë gjatë sezonës dimërore ka shpenzim të energjisë elektrike përafro të njëjtë me atë të muajit 01/2013.

Bordi i ZRRE-së vlerëson se fatura e muajit janar 2013 për konsumatorin me shifër DPR – 20946 ka qenë konform dispozitave të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës së Leximit dhe Faturimit.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.09.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_981_06_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar